

2326



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Kerkese per informacion Nr. Prot 156/23

ikosta@albaniandf.org <ikosta@albaniandf.org>

Wed, Nov 15, 2023 at 10:17 AM

To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Përshëndetje z. Matlija,

Pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) është përcjellë për trajtim nga Bashkia Himarë, përmes postës elektronike, kërkesa për informacion me nr. 156/23 prot. e Qendrës "Res Publica", në vijim të së cilës ju informojmë se:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit luan rolin e Njësisë Zbatuese në projektin për ndërtimin e rrjetit të furnizimit me ujë të fshatrave Pilur, Kudhës, Porto Palermo, Qeparo, Qeparo fshat, Vuno, Jalë, Livadh, Himarë fshat dhe Himarë Qytet, pjesë e programit "Furnizimi me ujë i zonave rurale IV", në zbatim të Marrëveshjes së Huas për këtë program të datës 03.06.2019 mes Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane KFW, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 18.07.2019.

Punimet për ndërtimin e veprës së marrjes dhe linjës së transmetimit të ujit nga Lepusha në Himarë kanë filluar më datë 10.01.2023 nga Kontraktori i punimeve B.O.E "Trema Engineering 2" sh.p.k. dhe "Strabag", ku Mbikëqyrës është CES Consulting Engineers Salzgitter GmbH.

Sa i përket ndërtimit të rrjetit shpërndarës të ujesjellësave për fshatrat Borsh, Qeparo, Himarë fshat, Jalë, Vuno, Livadh, Himarë qytet, Orikum dhe fshatrat përreth, punimet kanë filluar më datë 16.09.2022 nga ana e Kontraktorit të punimeve "Akelik Group", me Mbikëqyrës CES Consulting Engineers Salzgitter GmbH.

Punë të mbarë,



**FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT**

Ina KOSTA | Koordinator për të Drejtën e Informimit

F +355 (0)4 22 35 597/8

A Rruga "Sami Frashëri", Nr. 10 Tiranë – Albania

www.albaniandf.org

Drejtoria Kombëtare e Informimit